

VENDIM
Nr. 228, datë 13.4.2023

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2023, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E KULTURËS, PËR FINANCIMIN E FESTIVALIT FOLKLORIK
KOMBËTAR GJIROKASTËR, 24 QERSHOR–2 KORRIK 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Kulturës dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i shtohet fondi prej 130 065 200 (njëqind e tridhjetë milionë e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind) lekësh, për financimin e Festivalit Folklorik Kombëtar Gjirokastrë, që do të zhvillohet në datat 24 qershor–2 korrik 2023, i ndarë, si më poshtë vijon:

a) Në shpenzimet korrente, “Projekte të trashëgimisë kulturore”, shtohet fondi prej 117 335 200 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind) lekësh për mbulimin e shpenzimeve për akomodim, transport, publicitet, honorare, skenë, drita, foni, në kuadër të festivalit;

b) Në shpenzimet kapitale “Investime”, shtohet fondi prej 12 730 000 (dymbëdhjetë milionë e shtatëqind e tridhjetë mijë) lekësh për grantet e qarqeve dhe blerje pajisjesh për zonën e spektatorëve dhe ambiente të tjera në kala.

2. Fondi prej 130 065 200 (njëqind e tridhjetë milionë e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind) lekësh përballohet nga fondi rezervë i buxhetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku